

URDHËR
Nr.567, datë 23.11.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS NË
“SHKENCA POLITIKE”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE TË UNIVERSITETIT TË
TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 25 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, të programit të studimit të ciklit të tretë të Doktoratës në “Shkenca politike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” në “Shkenca politike”.

2. Programi i studimit të ciklit të tretë të Doktoratës zgjat të paktën 3 vite akademike dhe përfshin 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Programi i studimit të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

4. Programi i studimeve të ciklit të tretë të Doktoratës në “Shkenca politike”, të plotësojë kushtet e përcaktuara në vendimin nr.260, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj